



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3 Mars 2023

Nr: 89

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË BASHKISË RROGOZHINË,
PËR RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 3 Mars 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Z. Elton Sula, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Rrogozhinë

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Rrogozhinë, për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 28.1.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 2 (dy) veprimtarive publike nga ana e bashkisë Rrogozhinë.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

Data: 3 Mars 2023

Nr: 89
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Rrogozhinë, për raportimin e veprimtarive publike”

“Theksohet se këto aktivitete nuk janë raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.

1. *“Takim me banorët e fshatit Luz i Madh në Njësinë Administrative Lekaj, për të dëgjuar nga afër problemet të cilat sëbashku do ti gjejmë zgjidhjen sa më shpejt”.*

Link i aktivitetit:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=516189930728778&set=pcb.516189944062110>

2. *“Mbi 20 vite pune të palodhur nga familja Shaba në Gosë të Vogël, për të ngritur fermën e tyre me mbi 400 krerë bagëti dhe 30 hektarë tokë ku kultivohen kultura të ndryshme bujqësore”.*

Link i aktivitetit:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=518677687146669&set=pcb.518678437146594> ”

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Më datë 16.2.2023, bashkisë Rrogozhinë i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 17.2.2023, bashkia Rrogozhinë ndër të tjera bën me dije se: *“...Përsa i përket mosraportimit të veprimtarive publike që ju keni dërguar në email nuk janë raportuar për shkak të mungesës së informacionit nga ana jonë. Për veprimtaritë e tjera do jemi korrekt që të mos ketë probleme të tilla...”*.

Nga verifikimi i provave dhe fakteve, vlerësohet se referuar nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, veprimtaritë e kryera nga kryetari i bashkisë Rrogozhinë, nuk përbëjnë veprimtari publike dhe për rrjedhojë lidhur me këto veprimtari nuk rëndon detyrimi për raportim. Veprimtaritë publike përkojnë me përmbushjen e detyrave funksionale të kryetarit të bashkisë.

Në këto kushte, në mungesë edhe të informacionit nga ana e bashkisë Rrogozhinë, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Rrogozhinë, nuk përbën shkelje të nenit 92, Kodit

Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj z. Elton Sula, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Rrogozhinë.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Tërheqje vëmendje ndaj bashkisë Rrogozhinë, për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike.
4. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI